



Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBE KOSOVA
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD FOR THE CIVIL SERVICE OF KOSOVO



Datë: 08.05.2025

Numër protokoli: 3085/2025

A.nr.647/2025

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës – Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave në përbërje nga: Arben Mehmeti-kryetar, Malsore Gashi-Bajraktari dhe Eshref Shabani-anëtarë, me Flakron Gashi, në cilësinë e procesmbajtësit ka shqyrtuar ankesën A.nr.647/2025, të datës 14.04.2025, të parashtruar nga ankuesi A.B, kundër Komunës së Klinës, në çështjen juridike “*kontestim konkursi*”, duke vepruar në pajtim me nenin 6 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1 dhe nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.5 të Ligjit Nr. 06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës i ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin Nr.08/L-180, si dhe Rregulloren Nr.02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, me datë 08.05.2025, mori këtë:

V E N D I M

Përfundon procedimi administrativ i iniciuar sipas ankesës A.nr.647/2025 e datës 14.04.2025, të parashtruar nga ankuesi A.B.

A r s y e t i m

Kandidati për pranim në shërbimin civil, A.B (në *tekstin e mëtejme referuar*: Ankuesi), me datë 14.04.2025 ka parashtruar ankesë me numër protokoli 2458/2025 të regjistruar nën shenjë A.nr.647/2025 në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, kundër Njoftimit të datës 02.04.2025 për rezultatet përfundimtare, nga Njësia e Burimeve Njerëzore të Komunës së Klinës, me pretendimin ankimor se procedura e rekrutimit për pozitën Zyrtar i Lartë për Përfshirje Sociale në QPS Klinë.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës (në *tekstin e mëtejme referuar*: Këshilli) bazuar në dispozitat e Rregullores Nr.02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave, me datën 18.04.2025 ka proceduar kërkesën për përgjigje në ankesë tek Komuna e Klinës, ndërsa kjo e fundit me datë 24.04.2025, ka dorëzuar përgjigjen në ankesë lidhur me procedurën në fjalë.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave (në tekstin e mëtejme referuar: Kolegji i Këshillit) për vendosje meritore administroi këto prova: Ankesën A.nr.647/2025 të datës 14.04.2025 të parashtruar nga ankuesi në KPMSHCK; Njoftim të datës 17.03.2025; Njoftim të datës 02.04.2025 të Komunës së Klinës; Vendimin e datës 25.03.2025 i Kryetarit të Komunës me aktet përcjellëse; Konkursin e datës 14.02.2025; Kopjen e letërnjoftimit të ankuesit; Kërkesa për përgjigjen në ankesë e datës 14.04.2025; Përgjigje në kërkesë 24.04.2025 me shkresat përcjellëse.

Kolegji i Këshillit, pas shqyrtimit të shkresave të lëndës të parashtruar nga palët në procedurë, ka konstatuar se janë plotësuar parakushtet ligjore që të **përfundoi procedimi administrativ** i filluar me ankesën e ankuesit, **sepse:**

Kolegji i Këshillit nga administrimi i shkresave të lëndës ka gjetur se Komuna Klinës, më datë 14.02.2025 ka shpallë konkursin me numër Reference RN00016760, për Grupi i Përgjithshëm i Shërbimeve Sociale, për pozitën e punës *“Zyrtar i Lartë për Përfshirje Sociale”*-Profesional 1, ku afati për aplikim ka qenë nga data 15.02.2025 deri më 16.03.2025, ndërsa nga shkresat e lëndës arrihet në konstatimin se edhe ankuesi ka aplikuar në këtë konkurs.

Tutje, nga shkresat e lëndës rezulton se ankuesi sipas Njoftimit të datës 17.03.2025, e ka kaluar fazën e verifikimit paraprak dhe i njëjti i është nënshtruar edhe procedurave të tjera të konkursit, kurse sipas Njoftimit të datës 14.02.2025 rezulton se nuk është kandidatë i suksesshëm, gjegjësisht kandidate e suksesshme rezulton të jetë kandidatja D.G-R me gjithsejtë 91.4 pikë, ndërsa ankuesi kundër të njëjtit akt ka parashtruar ankesë në Këshill me datë 14.04.2025, mirëpo i njëjti me datë 25.04.2025 është tërhequr nga ankesa.

Nisur nga rrethanat e paraqitura si më lartë, Kolegji i Këshillit analizoi dispozitat e nenit 103 paragrafi 1 dhe 2 të Ligjit Nr.05/L-031 për procedurën e Përgjithshme Administrative ku përcaktohet se: *“1. Një procedurë administrative e nisur sipas kërkesës, përfundon nëse pala që e ka bërë kërkesën e tërheq atë; 2. Procedura administrative e nisur sipas kërkesës, gjithashtu do të përfundohet, kur nga rrethanat rezulton pa asnjë dyshim se pala nuk ka më interes në vazhdimin e saj dhe e ka braktisur atë”* dhe erdhi në përfundimin se ankuesi përmes parashtresës së datës 25.04.2025 me numër protokolli:2747/2025 është tërhequr nga ankesa e tij e datës 14.04.2025 e parashtruar në Këshill, dhe mbi këtë bazë Kolegji i Këshillit konstatoi se janë plotësuar parakushtet ligjore që të përfundohet procedimi administrativ si në dispozitivin e këtij vendimi, lidhur me ankesën e ankueses A.nr.647/2025 të datës 14.04.2025.

Andaj, pas analizimit dhe vlerësimit të të gjitha shkresave të lëndës si dhe duke u bazuar nenin 6 paragrafi 1, nën paragrafi 1.1 si dhe nenin 18 paragrafi 1 nën paragrafi 1.5 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, dhe nenit 103 paragrafi 1 dhe 2 të Ligjit Nr.05/L-031 për procedurën e Përgjithshme Administrative, Kolegji i Këshillit vendosi si në dispozitiv të këtij Vendimi.

Vendim hynë në fuqi në ditën e nënshkrimit nga Kryetari i Kolegjit.

Këshillë juridike: Pala e pakënaqur e cila pretendon se vendimi i Këshillit nuk është i ligjshëm mund të iniciojë konflikt administrativ në Gjykatën Themelore në Prishtinë/Departamenti për Çështje Administrative, brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk e ndalon ekzekutimin e këtij Vendimi.

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
Lënda, A.nr.647/2025, datë 08/05/2025.

Flakron GASHI

Procesmbajtës

Arben MEHMETI

Kryetar i Kolegjit

Vendimi i dorëzohet:

- Ankuesit A.B;
- Komuna e Klinës (Udhëheqësit të Burimeve Njerëzore), si dhe;
- Arkivit të KPMSHCK-së.